



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 126

Tiranë – E premte, 2 qershor 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 73/2017, datë 27.4.2017	Për miratimin e shtesës së Marrëveshjes së Koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe NESKO METAL SAN.TIC.A.Ş, si Koncesionari, për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit..... 6443
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 30.5.2017	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale..... 6455
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 30.5.2017	Për shkarkimin nga detyra të drejtorit të Cirkut Kombëtar..... 6456
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 30.5.2017	Për disa shtesa në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6456
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 30.5.2017	Për mbulimin e shpenzimeve të transportit për në atdhe të trupit të të ndjerit Gjovalin Kadeli..... 6457
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 1.6.2017	Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017..... 6457
Urdhër i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 124, datë 1.6.2017	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 113, datë 22.5.2017, “Për delegimin e kompetencave”..... 6461



**LIGJ**  
**Nr. 73/2017**

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË  
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT  
NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË  
DHE INDUSTRIISË, SI AUTORITET  
KONTRAKTUES, DHE NESKO METAL  
SAN.TIC.A.Ş, SI KONCESIONARI, PËR  
DISA OBJEKTE TË INDUSTRIISË SË  
BAKRIT DHE TË KROMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe NESKO METAL SAN.TIC.A.Ş, si koncesionari, për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.4.2017

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME TË  
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË  
FORMËS “BOT” NDËRMJET MINISTRISË  
SË EKONOMISË PUBLIKE DHE  
PRIVATIZIMIT DHE SHOQËRISË SË TË  
DREJTËS TURKE “BER-ONER” PËR DISA  
OBJEKTE TË INDUSTRIISË SË BAKRIT DHE  
TË KROMIT, SI DHE PËR DHËNIEN E DISA  
STIMUJVE DHE GARANCIVE PËR  
KONCESIONARIN E KËSAJ  
MARRËVESHJEJE**

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Koncesionit (“Marrëveshje”) është nënshkruar më datë 21.3.2017, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe

Industrisë (“MEP”), me adresë në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si “Autoriteti Kontraktues”) përfaqësuar nga Z. Damian Gjoknuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe NESKO METAL SAN.TIC.A.Ş.s.r.l, një shoqëri e së drejtës Turke me seli të shoqërisë në Stamboll, Turqi, përfaqësuar nga z. Erol Kohen, Administrator i NESKO METAL SAN.TIC.A.Ş, (ish-Ber-Oner Madencilik san.ve.tic.A.Ş), (këtu e më poshtë referuar si “Koncesionari”). Secili prej Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit do të quhen individualisht “Pala” dhe bashkërisht “Palët”.

Meqenëse:

A) Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe Ber-Oner Madencilik SAN.VE.TIC.A.Ş, më datë 18.1.2001, është firmosur një Marrëveshje Koncesioni e formës BOT (“Marrëveshja e Koncesionit”), e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8761, datë 2.4.2001, “Për miratimin e “Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë së të Drejtës Turke “Ber-Oner” për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit, si dhe për dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshjeje”;

B) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e konsideron sektor të rëndësishëm sektorin minerar dhe kërkon që të rivitalizojë investimet në këtë sektor;

C) Në vitin 2007, Ber-Oner Madencilik san.ve.tic.A.Ş ndryshoi emërtimin në NESKO MADEN SAN.TIC.A.Ş. Kapitali i kësaj të fundit (përfshirë shoqërinë koncesionare “Beralb” SH.A.), pas një procesi ndarje të realizuar në përputhje me legjislacionin tregtar turk, i kaloi shoqërisë së re NESKO METAL SAN.TIC.A.Ş;

D) Ministria e Energjisë dhe Industrisë është Ministria përgjegjëse për sektorin minerar dhe Autoritet Kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor;

E) Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare “BERALB” SH.A., në periudhën kohore 2001 - 2015, kanë investuar rreth 70 milionë USD, nga 32 milionë USD që Koncesionari detyrohej të investonte për të gjithë periudhën koncesionare 2001 – 2031.



F) Koncesionari ka përmbushur në tërësi detyrimet e tjera që rrjedhin nga Marrëveshja e Koncesionit.

G) Palët njohin faktin se që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Koncesionit dhe deri në nënshkrimin e kësaj Shtesë-Marrëveshjeje, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në legjislacionin që lidhen me kontratat e koncesionit, legjislacionin mineralar dhe atë fiskal dhe se është e domosdoshme që bashkëpunimi mes Palëve të marrë në konsideratë këto ndryshime;

H) Palët njohin dhe pranojnë faktin që për një shfrytëzim optimal, racional dhe eficient të burimeve minerale të dhëna në koncesion, është i nevojshëm përditësimi, shtimi dhe/ose ndryshimi i investimeve dhe prioriteteve të këtyre investimeve të përcaktuara fillimisht në Marrëveshjen e Koncesionit.

I) Ministria e Energjisë dhe Industrisë është e interesuar që të promovojë investitorët që realizojnë investime të konsiderueshme nëpërmjet të cilave jo vetëm që realizohet shfrytëzimi efektiv i pasurive minerale, por edhe krijohen efekte pozitive në ekonomi nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës;

Bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Përveçse kur ndryshohen shprehimisht nga kjo Shtesë-Marrëveshje dhe/ose bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj të fundit, dispozitat e Marrëveshjes së Koncesionit, miratuar me ligjin nr. 8761, datë 2.4.2001, do të vazhdojnë të jenë në fuqi me efekt të plotë dhe detyrues për Palët.

Kjo Shtesë-Marrëveshjeje, bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit dhe kudo ku përdoret termi “Marrëveshje Koncesioni” do të konsiderohet se ky term përfshin edhe këtë Shtesë-Marrëveshjeje.

#### Neni 2

Neni 1 i Marrëveshjes së Koncesionit, “Përkufizime”, ndryshon si më poshtë vijon:

“Marrëveshje Koncesioni”: Është kjo Shtesë-Marrëveshje dhe Marrëveshja e Koncesionit e miratuar me ligjin nr. 8761, datë 2.4.2001.

“Koncesionari”: Ka kuptimin që i është dhënë në këtë Shtesë-Marrëveshjeje.

“Shoqëri Koncesionare”: Është shoqëria tregtare e themeluar nga Koncesionari për zbatimin e Marrëveshjes së Koncesionit.

“Autoriteti Kontraktues” Është ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare dhe që legjislacioni në fuqi e ka autorizuar të jetë si palë për efekt të zbatimit të Marrëveshjes së Koncesionit.

Kudo ku në Marrëveshjen e Koncesionit është përdorur termi “Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)”, do të zëvendësohet nga termi “Autoriteti Kontraktues” (AK).

“Palët”: Ka kuptimin që i është dhënë në hyrje të kësaj Shtesë-Marrëveshjeje.

“Kontratat”: Të gjitha kontratat e përfunduara për të siguruar shërbimet, pajisjet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit;

“Sipërmarrës”: Të gjithë nënkontraktorët dhe furnizuesit për zbatimin, ndërtimin, furnizimin e bazës materiale dhe të pajisjeve teknologjike të nevojshme për realizimin e koncesionit;

“Ndryshimi i ligjit”: Do të thotë çdo akt ligjor dhe/ose nënligjor i miratuar nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Koncesionit.

“Objekti i Marrëveshjes”: Objektet e industrisë se bakrit të specifikuar në aneksin 1 bashkëngjitur kësaj Shtesë-Marrëveshjeje, i cili do të zëvendësojë Aneksin 1 të Marrëveshjes së Koncesionit miratuar me ligjin nr. 8761, datë 2.4.2001;

“Lejet”: Lejet, licencat dhe autorizimet që mund të kërkohen për zbatimin e plotë të Projektit;

“Periudha e koncesionit”: Është 45 vjet nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Koncesionit të miratuar me ligjin nr. 8761, datë 2.4.2001;

“Ditë Pune” do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare.

“Plani i Ri i Investimeve” do të thotë investimet e reja që do të kryhen nga Koncesionari dhe/ose Shoqëria Koncesionare që specifikohen në aneksin nr. 2, i cili do të zëvendësojë aneksin 2 të Marrëveshjes Koncesionare.

“Raporti i Progresit” do të thotë dokumenti i përgatitur çdo vit nga Koncesionari dhe i miratuar nga Autoriteti Kontraktor, ku paraqitet ecuria e investimeve të realizuara gjatë vitit, investimet e përcaktuara, shkaqet e mosrealizimit të tyre, propozimet për ndryshimet e zërave dhe/ose



vlerave të investimeve të parashikuara për t'u realizuar nga Koncesionari, si dhe masat që duhet të ndërmarrin Palët për kryerjen e investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

“Objekt i Koncesionit” do të thotë objektet dhe/ose asetet e përmenduar në nenin 2 të Kontratës së Koncesionit, si dhe në aneksin nr. 1, i ndryshuar.

“Financuesit e Projektit” do të thotë çdo person apo persona që financojnë apo rifinancojnë borxhe (hua) të Koncesionarit apo/dhe shoqërisë Koncesionare në lidhje me Projektin.

“Person” do të thotë çdo individ, person fizik apo shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar, ndërmarrje, institucion publik i pushtetit qendror, vendor, apo i pavarur (në çdo rast, me ose pa personalitet juridik të veçantë).

#### Neni 3

Neni 2 i Marrëveshjes së Koncesionit – “Objekti i Marrëveshjes” ndryshon si më poshtë vijon:

“Kjo marrëveshje ka për objekt dhënien me koncesion të objekteve minerare të përcaktuara në aneksin 1 bashkëngjitur kësaj Shtesë-Marrëveshje”.

#### Neni 4

Neni 3 i Marrëveshjes së Koncesionit – “Kriteret specifike të punimeve”, ndryshohet si më poshtë vijon:

3.1 Kriteret specifike të punimeve, grafiku i planit të ri të investimeve, si dhe vlera e investimeve që do të kryhen sipas fazave të punimeve e objekteve përkatëse minerare, përcaktohet në mënyrë më të detajuar në aneksin 2 bashkëngjitur kësaj Shtesë-Marrëveshjeje.

3.2 Koncesionari do të marrë masat që të vërë në zbatim/implementojë brenda një periudhe kohore prej 9 vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje (“Periudha e Investimeve”), shumën e investimeve të përshkruara në Planin e Ri të Investimeve.

3.3 Koncesionari mundet të ndryshojë grafikun e punimeve, natyrën e punimeve, objektin minerar ku punohet, të përcaktuar në aneksin 2, vetëm pasi të jetë marrë miratimi nga Autoriteti Kontraktues.

3.4 Nëse Koncesionari ka bërë më shumë investime se sa është parashikuar në aneksin 2 për një Fazë Investimi (periudha trevjeçare) dhe këto investime janë konfirmuar nga Raportet vjetore të

Progresit, të miratuara, atëherë teprica e këtij investimi do t'i llogaritet si investim i bërë në fazën pasardhëse. Nëse Koncesionari ka bërë më pak investime se sa është parashikuar në aneksin 2 për një Fazë Investimi (periudha trevjeçare) dhe kjo është e konfirmuar nga Raportet e Progresit të miratuara vjetore, atëherë Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues, si kusht penal vlerësues, një shumë (e referuar më poshtë si një “Shumë Penaliteti”), që llogaritet duke aplikuar përqindjen përkatëse të përcaktuar më poshtë, mbi totalin e miratuar të investimeve për Fazën e Investimit përkatëse minus çdo shumë të investuar konkretisht nga ana e Koncesionarit (dhe të konfirmuar nga Raportet e Progresit të miratuara vjetore) për atë fazë. Diferenca ndërmjet totalit të miratuar të investimeve për një Fazë Investimesh dhe investimeve aktuale për atë fazë do të referohet si Investimi i Munguar. Shuma e Penalitetit do të jetë e barabartë me 10% të Investimit të Munguar.

Çdo Shumë Penaliteti do paguhet nga Koncesionari, Autoritetit Kontraktues në përfundim të çdo faze investimesh brenda 2 (dy) muajve nga kërkesa me shkrim që i dorëzohet Koncesionarit për këtë qëllim, duke përfshirë dhe një detajim të hollësishëm për llogaritjen, sipas Raportit të Progresit në përputhje me parashikimet e këtij neni. Nëse pagesa nuk ndodh brenda periudhës 2-mujore sipas paragrafit më sipër, Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një kamatë vonesë, të barabartë me kamatë vonesën ligjore të përcaktuar sipas legjislacionit shqiptar.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse investimet e planifikuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje nuk janë kryer në kohë për shkak të Forcës Madhore dhe për sa kohë zgjat efekti i kësaj Forcë Madhore apo për shkak të një mospërmbushje të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Koncesionari nuk do të jetë i detyruar të paguajë asnjë Shumë Penaliteti ndaj Autoritetit Kontraktues. Për shmangien e çdo dyshimi, pagesa e Shumës së Penalitetit për çdo Fazë Investimesh përfaqëson shpërblimin e dëmit dhe detyrimin e vetëm që ka Koncesionari ndaj Autoritetit Kontraktues për mospërmbushjen e detyrimit të tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit në lidhje me mospërmbushjen e tij për kryerjen e investimeve.



Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje në lidhje me përcaktimin e Shumës së Penalitetit dhe/ose pagesën e saj do të zgjidhet sipas nenit 23 të Marrëveshjes së Koncesionit.

#### Neni 5

Neni 4 i Marrëveshjes së Koncesionit – “Koha e fillimit të punimeve”, ndryshon si më poshtë vijon:

“Punimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje fillojnë dhe kryhen në përputhje me grafikun e Planit të Ri të Investimeve, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 6

Në nenin 5 të Marrëveshjes së Koncesionit – “Detyrimet e Koncesionarit”, ndryshon paragrafi 5.3 dhe 5.6, si dhe shtohet paragrafi 5.7 dhe 5.8 si më poshtë vijon:

“5.3 Të respektojë të drejtën e Autoritetit Kontraktor për ruajtjen e pronësisë së mjeteve kryesore (inventarit) të marrë në koncension, për sa kohë ato nuk janë nxjerrë jashtë përdorimi, apo bërë të pamundura për t'u rikuperuar nga Koncesionari.

Koncesionari në rastin e zëvendësimit, rehabilitimit, rikuperimit, nxjerrjes jashtë përdorimi të mjeteve kryesore (inventarit) sipas legjislacionit në fuqi, të marra në koncension, njofton Autoritetin Kontraktues.

5.6 Me përjashtim kur është parashikuar ndryshe në Marrëveshjen e Koncesionit apo/dhe në këtë Marrëveshje, Koncesionari dhe/ose Shoqëria Koncesionare nuk mundet të transferojë, apo të vendosë barrë, peng, hipotekë, mbi të gjithë apo një pjesë të Objekteve të Koncesionit, ekzistuese apo të krijuara, dhe/ose të gjitha apo një pjesë të të drejtave dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe/ose kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

5.7 Koncesionari ka të drejtë që pas marrjes së miratimit me shkrim të Autoritetit Kontraktues, dhe nëse kjo kërkohet nga Financuesit e Projektit dhe vetëm për qëllim të financimit të Projektit, të vendosë barrë mbi Objektet e Koncesionit, përfshi dhe kuotat/aksionet e Shoqërisë Koncesionare, të vendosë hipotekë mbi asetet ekzistuese që përbëjnë Objektivin e Koncesionit apo

ato të krijuara, apo të transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat apo/dhe interesat e tij në lidhje me Projektin, me qëllim vendosjen e garancive në favor të Financuesve të Projektit.

5.8 Koncesionari nuk mundet që pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues të transferojë Marrëveshjen e Koncesionit të një palë e tretë. Palët bien dakord që miratimi me shkrim i Koncesionarit duhet të jepet brenda 30 ditëve kalendarike nga kërkesa e Koncesionarit e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e palës së tretë dhe së një miratim i tillë nuk mund të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të paarsyeshme. Do të konsiderohet se refuzimi është i paarsyeshëm nëse pala e tretë të cilës propozohet t'i transferohet Marrëveshja e Koncesionit ka të paktën të njëjtat karakteristika teknike dhe/ose financiare me Koncesionarin. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë në çdo moment. Gjatë kësaj kohe, afatet konsiderohen të pezulluara. Nëse Autoriteti Kontraktues dështon të japë një përgjigje për kërkesën brenda afatit 30-ditor, atëherë Palët bien dakord se kërkesa do të konsiderohet e miratuar në heshtje nga ana e tij (Autoritetit Kontraktues).”

#### Neni 7

Neni 7 i Marrëveshjes së Koncesionit – “Detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar”, ndryshon si më poshtë vijon:

“Detyrimet e Autoritetit Kontraktues”

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

a) Të vërë në dispozicion të Koncesionarit dhe/ose Shoqërisë Koncesionare Fabrikën e Mjedës në gjendjen në të cilën ndodhet ditën e nënshkrimit të kësaj Shtesë-Marrëveshjeje.

b) Autoriteti Kontraktues, brenda kompetencave të tij ligjore, do të pajisë shoqërinë koncesionare me të gjitha lejet, licencat, autorizimet dhe me çdo akt tjetër, në përgjegjësi të tij, të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncesionare dhe do të bëjë në kohë ripërtëritjen, zëvendësimin, zgjatjen e lejeve, licensave apo autorizimeve, me kusht që shoqëria koncesionare të ketë dorëzuar në kohë dhe konform legjislacionit shqiptar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar. Autoriteti Kontraktues nuk



do të shfuqizojë, revokojë apo bëjë të pavlefshëm këto leje, autorizime apo licenca gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncesionare, apo të vendosë detyrime të tjera shtesë ndaj shoqërisë koncesionare për marrjen, zgjatjen, ripërtëritjen, vlefshmërinë e këtyre lejeve, licencave, autorizimeve apo çdo akt/veprim tjetër, si kusht për të kryer njërën, disa, apo të gjitha nga veprimet/aktet e përmendura në këtë paragraf, me kusht që shoqëria koncesionare të ketë respektuar kërkesat që ka legjislacioni shqiptar për këto leje, licenca, autorizime.

c) Autoriteti Kontraktues do të asistojë në institucionet përgjegjëse, shoqërinë koncesionare për pajisjen me çdo leje, licencë, autorizim tjetër të nevojshëm për aktivitetin koncesionar gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit dhe do t'i garantojë Koncesionarit dhe/ose Shoqërisë Koncesionare ekskluzivitetin për realizimin e Projektit, për objektet e dhëna në koncesion gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

d) Të bëjë propozimet përkatëse dhe të asistojë në mbrojtjen e nevojshme, në organet kompetente gjyqësore shqiptare, për të realizuar mbështetjen për Projektin.

e) Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi që lidhet me pretendimet e personave të ndryshëm për pronësi mbi tokën dhe objektet e dhëna në koncesion, si dhe pretendimet e të tretëve për borxhet që mund të kenë objektet e kësaj Marrëveshjeje.

f) Të marrë përsipër të mbajë të lira rrugëkalimet dhe hyrjet në objektet e koncesionit.

g) Të ndihmojë dhe të asistojë Koncesionarin për zgjidhjen e konflikteve nga pretendimet e padrejta të të tretëve ndaj tij, lidhur me problemet e mbrojtjes së mjedisit, apo edhe për pretendime të tjera të padrejta nga të tretët për zhdëmtime të natyrave të ndryshme.

h) Të marrë në dorëzim nga Koncesionari objekte të veçanta të koncesionit, të cilat do të rezultojnë pa efektivitet ekonomik.

i) Për energjinë që mund të dojë të prodhojë vetë Koncesionari, të përjashtohet nga taksat doganore dhe TVSH-ja, për makineritë, pajisjet dhe lëndën djegëse që do të duhen për prodhimin e kësaj energjie elektrike; si dhe të ndihmojë/asistojë Koncesionarin për marrjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, sipas legjislacionit në fuqi.

j) Të ruajë dhe të aplikojë për Shoqërinë Koncesionare gjatë gjithë periudhës koncesionare nivelin prej 3% të taksës së rentës minerare për mineralin bakër dhe nënproduktet e tij, si dhe të zbatojë metodologjinë e llogaritjes në përputhje me aneksin 3 bashkëngjitur kësaj Shtesë-Marrëveshjeje.

k) Të sigurojë Koncesionarin dhe Shoqërinë Koncesionare edhe me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit Shtet në industrinë minerare, se legjislacioni në fuqi (dhe jo vetëm ai minerar) në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet gjatë gjithë periudhës së koncesionit. Ndryshimet në këtë legjislacion, përfshirë këtu edhe hyrjen në fuqi të ligjeve të reja, nuk do të jenë të zbatueshme, me përjashtim të rastit kur këto ndryshime ligjesh ose ligje të reja që hyjnë në fuqi favorizojnë Koncesionarin dhe/ose Shoqërinë Koncesionare. Në mënyrë të posaçme, Autoriteti Kontraktues garanton Koncesionarin dhe Shoqërinë Koncesionare se gjatë gjithë periudhës koncesionare do të ruhet e do të aplikohet niveli i TVSH-së, Tatimit mbi Fitimit, Tatimit mbi Dividentin sipas aneksit 3 bashkëngjitur kësaj Shtesë-Marrëveshjeje.

l) Autoriteti Kontraktues, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Marrëveshjen e Koncesionit, do të mbajë të padëmtuar Koncesionarin dhe/ose Shoqërinë Koncesionare nga çdo pasojë që i vjen këtyre të fundit nga dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij, të shprehura në Marrëveshjen e Koncesionit, këtë Shtesë-Marrëveshjeje dhe/ose detyrimet e tij sipas legjislacionit.

#### Neni 8

Në nenin 8 të Marrëveshjes së Koncesionit - “Vlerësimi i Investimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Titulli i nenit 8 ndryshon nga “Vlerësimi i Investimit”, në “Miratimi i Planit të Investimeve”.

Pas pikës 8.3, të nenit 8 të Marrëveshjes së Koncesionit shtohen pikat 8.4, 8.5, 8.6, 8.7, 8.8, 8.9, 8.10 respektivisht me këtë përmbajtje:

“8.4 Brenda datës 31, të muajit mars të çdo viti, Shoqëria Koncesionare i paraqet Autoritetit Kontraktues Raportin e Progresit, në të cilin paraqet ecurinë e investimeve të vitit paraardhës, si dhe ecurinë progresive të investimeve nga fillimi i Planit të Ri të Investimeve deri në fundin e vitit paraardhës. Raporti i Progresit shoqërohet me



shpjegime të hollësishme për investimet e realizuara, investimet e porealizuara, arsyet e mosrealizimeve nëse ka, masat që do ndërmerren Koncesionari për realizimin e investimeve që nuk janë kryer gjatë vitit paraardhës, veprimet që kërkohen të ndërmerren nga Autoriteti Kontraktues në përmbushje të detyrimeve të tij kontraktuale dhe/ose ligjore, nevojat për investime të reja, nevojat për ndryshime të zërave të investimeve.”

8.5 Brenda 2 javëve nga marrja e Raportit të Progresit, personat e autorizuar të Palëve, nëse është nevoja, shqyrtojnë së bashku Raportprogresin, si dhe për masat që duhen marrë nga Palët për zbatimin e këtij Plani të Ri të Investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

8.6 Diskutimet për planin e investimeve të vitit ushtrimitor përfundojnë brenda 2 javëve nga takimi i parë sipas paragrafit 8.5 më sipër, dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga dita e paraqitjes së Raportit të Progresit.

8.7 Palët evidentojnë në një dokument të firmosur nga ato (Palët) masat që duhet të ndërmerren nga Palët për zbatimin e Planit të Ri të Investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

8.8 Nëse Koncesionari konstaton se për shkak të ndryshimit të rrethanave është e nevojshme ndryshimi i Planit të Ri të Investimeve, ai i paraqet Autoritetit arsyet dhe nevojat e këtij ndryshimi, si dhe investimet që ai mendon se duhen ndryshuar. Procedurat, format dhe afatet e paraqitjes dhe diskutimit të ndryshimeve në Planin e Ri të Investimeve janë të njëjta me ato të përshkruara në paragrafët 8.4, 8.5 dhe 8.6 më sipër.

8.9 Nëse Palët arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e Planit të Ri të Investimeve, kjo marrëveshje evidentohet në formë të shkruar (në formën e një dokumenti të firmosur nga të dyja palët). Ky dokument ka fuqi detyruese për Palët dhe bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit.

8.10 Nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e Planit të Ri të Investimeve sipas parashikimeve më sipër, Koncesionari dhe/ose Shoqëria Koncesionare, për aq sa është e mundur, do të vazhdojë me implementimin e Planit të Ri të Investimeve sipas parashikimeve të aneksit nr. 2.

#### Neni 9

Neni 9 i Kontratës së Koncesionit ndryshon si më poshtë:

Faqe | 6448

“9.1 Periudha e Koncesionit përfundon më datë 31 dhjetor 2043.

9.2 Periudha e caktuar në pikën 9.1 mund të zgjatet nëse verifikohet një ngjarje e forcës madhore.”

#### Neni 10

Në nenin 11 të Kontratës së Koncesionit, Mbështetja për projektin, shtohet pika 11.4 si më poshtë vijon:

“11.4 Autoriteti Kontraktor do të asistojë Koncesionarin që TVSH-ja t’i rimbursohet rregullisht brenda afateve të përcaktuara në ligj.”

#### Neni 11

Neni 19 i Marrëveshjes Koncesionare –“Forca Madhore”, ndryshon si më poshtë vijon:

“Forca Madhore

19.1 “Forcë Madhore”do të thotë çdo rrethanë që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të njëres Palë (“Pala e Cenuar”) për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Koncesionit (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

a) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cenuar;

b) pala e cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masa të arsyeshme alternative, në mënyrë që të shmange pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshje Koncesioni dhe për të zbutur pasojat e saj;

c) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar të një prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Koncesionit; dhe

d) pala e cenuar t’i ketë dhënë njoftim Palës tjetër për këtë rast të Forcës Madhore.

Pa kufizuar frymën e përgjithshme të paragrafit më sipër, secila nga rrethanat e mëposhtme, në masën që është në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafët më sipër, do të përbëjë rast të Forcës Madhore:

a) veprimet e luftës, pushtimi ose aktet e një armiku të huaj, ose akte të terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;



b) akte të rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizmit, ose sabotazhi me natyrë politike apo të çdo lloj natyre tjetër;

c) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

d) epidemia;

e) grevat ose veprimtaritë për të ndaluar dhe/ose për të ngadalësuar punën;

f) ngjarje të tjera të jashtëzakonshme të natyrës politike dhe/ose ekonomike me ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e aktivitetit minerar në përgjithësi.

19.3 Palët nuk mund të jenë përgjegjës në rast mospërbushjeje të detyrimeve të tyre, të parashikuara nga kjo Marrëveshje, si pasojë e ndodhjes së njëres prej ngjarjeve të forcës madhore.

19.4 Në rastin kur një detyrim i parashikuar nga kjo Marrëveshje vonohet ose bëhet i pamundur nga një ngjarje e forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim menjëherë Palën tjetër, duke treguar motivet e pamundësisë ose vonësës dhe masat e marra për të evituar pasojat.

19.5 Gjatë zbatimit të Marrëveshjes, në rast se verifikohen ndodhi të forcës madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të Palëve, ato nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

19.6 Periudha e ndërprerjes dhe shtyrja e afateve të parashikuara për përmbushjen e detyrimeve përkatëse konfirmohet me një procesverbal të përpiluar nga Palët.

19.7 Periudha e Koncesionit do të zgjatet me një periudhë të barabartë me atë të kohëzgjatjes së ngjarjes së forcës madhore edhe për një periudhë kohe të mëtejshme të nevojshme, që Palët bien dakord për të eliminuar pasojat dhe për të rifilluar punimet.

#### Neni 12

Neni 20 i Marrëveshjes së Koncesionit ndryshon si më poshtë vijon:

“20.1 Kjo Marrëveshje Koncesioni hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj prej palëve dhe pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

20.2 Marrëveshja e Koncesionit nuk mund të ndryshohet përveçse kur ka një marrëveshje me shkrim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe

Koncesionarit. Një marrëveshje e tillë bëhet efektive;

a) me miratimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në rastet kur parashikohen ndryshime të nenit 7 (germa “j”), nenit 7 (germa “k”), si dhe nenit 9;

b) në të gjitha rastet e tjera, me nënshkrimin e saj nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 13

Pas nenit 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1.

#### Veçueshmëria

Nëse ndonjë kusht apo nen i kësaj Marrëveshje dhe/ose Marrëveshjes së Koncesionit në tërësi rezulton apo shpallet i pavlefshëm, i paligjshëm, i pazbatueshëm, nenet dhe kushtet e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Marrëveshjes së Koncesionit në tërësi mbeten të pacenuara.”

#### Neni 14

Neni 24 i Marrëveshjes së Koncesionit ndryshon si më poshtë vijon:

“Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit. Njoftimet.

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari marrin përsipër reciprokisht të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshje Koncesioni.

Çdo komunikim apo njoftim midis palëve do të jetë në formë të shkruar, në gjuhën angleze dhe/ose shqipe.

Çdo komunikim apo njoftim që njëra palë i dërgon tjetres duhet të dërgohet në njëren nga adresat e mëposhtme:

- Për Autoritetin Kontraktues:

Adresa postare:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë,

Blvd “Dëshmorët e Kombit” 1001,

Tiranë, Shqipëri.

- Për Koncesionarin:

Adresa postare:

Rr. “Papa Gjon Pali II”,

ABA Business Centre, kat. 13,

Tiranë, Shqipëri.





Në rast ndryshimi të të dhënave të adresave të sipërcituara, secila prej palëve ka detyrimin të njoftojë për këtë fakt palën tjetër brenda 10 ditëve kalendarike.

## Neni 15

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në dy kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë. Kjo Marrëveshje është marrëveshja përfundimtare dhe ekskluzive midis Palëve dhe tejkalon çdo negociatë apo marrëveshje me shkrim apo verbale ndërmjet Palëve.

## Neni 16

Kjo Marrëveshje, hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj dhe hyrjes në fuqi të ligjit që do t'a miratojë atë.

PËR MINISTRINË E ENERGJISË DHE  
INDUSTRIË,

**Z. Damian Gjikhuri**

PËR SHOQËRINË  
NESKO METAL SAN.TIC.A.Ş

**Z. Erol Kohen**

Përfaqësuar nga

**Z. Altin Ibro**

## ANEKSI 1

## OBJEKTET E MARRËVESHJES SË KONCENSIONIT

1. MINIERA E BAKRIT MUNELLË (shfrytëzim)
  2. MINIERA E BAKRIT LAK ROSHI (shfrytëzim)
  3. MINIERA E BAKRIT KARMË (shfrytëzim)
  4. FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT FUSHË-ARRËZ (përpunim)
  5. IMPLANTI I FRAKSIONIMIT TË SKORIEVE TË BAKRIT SHËNGJIN (përpunim)
  6. FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT MJEDË SHKODËR (përpunim)
1. OBJEKTI KONCESIONAR MINIERA E BAKRIT MUNELLË

**Koordinatat në plan të Objektivit Koncesionar Munellë dhe Karrierës së materialit mbushës që përfshihet në të**

Kordinatat shtetërore në plan		
Numri i pikës kufizuese	Y	X
1	4421575	4649968
2	4422000	4649968
3	4422571	4649810
4	4422656	4649690
5	4423139	4649577
6	4423288	4649750
7	4424591	4649750
8	4424591	4648223
9	4423086	4648223
10	4423086	4649404
11	4422004	4649740
12	4421523	4649631
13	4421479	4649862
S = 2.641 km <sup>2</sup>		



## 2. OBJEKTI KONCESIONAR MINIERA E BAKRIT LAK ROSHI

Koordinatat në plan të Objektivit Koncesionar Lak Roshi		
Koordinatat shtetërore në plan		
Numri i pikës kufizuese	Y	X
1	4424250	4658430
2	4424380	4658520
3	4424960	4658520
4	4425230	4658750
5	4425530	4658750
6	4426380	4657920
7	4426380	4656850
8	4425180	4656850
9	4424700	4657650
10	4424700	4658050
11	4424320	4658300
12	4424020	4658300
13	4423950	4658500
14	4423900	4658550
15	4422180	4659450
16	4421700	4660000
17	4421500	4660000
18	4421500	4660100
19	4421900	4660200
20	4422000	4660000
21	4422180	4659480
S = 2.986 km <sup>2</sup>		

3. OBJEKTI KONCESIONAR MINIERA E BAKRIT KARMË (shfrytëzim - përfshin lejen minerare nr. 1555, datë 22.2.2012)

Koordinatat në plan të Objektivit Koncesionar Karmë		
Koordinatat shtetërore në plan		
Numri i pikës kufizuese	Y	X
1	4401500	4662500
2	4401750	4661800
3	4399700	4660450
4	4400575	4656350
5	4397575	4658625
6	4398200	4661250
S = 10.517 km <sup>2</sup>		



4. OBJEKTI KONCESIONAR FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT FUSHË-ARRËZ (përpunim - përfshin objektet ndërtimore të fabrikës, rrugët dhe dambën e sterileve sipas procesverbalit të dorëzimit, datë 2.6.2004)

5. OBJEKTI KONCESIONAR IMPIANTI I FRAKSIONIMIT TË SKORIEVE TË BAKRIT SHËNGJIN (përpunim - sipas procesverbalit të dorëzimit datë 29.7.2003)

Koordinatat në plan të Objektivit Koncesionar Impianti i Fraksionimit të Skorieve të Bakrit Shëngjin		
Koordinatat shtetërore në plan		
Numri i pikës kufizuese	Y	X
1	4632252.5	4382792.5
2	4632247.5	4382880.0
3	4632205.5	4382878.5
4	4632208.0	4382814.5
5	4632230.5	4382815.0
6	4632232.5	4382790.0
S = 0.003232 km <sup>2</sup>		

6. OBJEKTI KONCESIONAR FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT MJEDË SHKODËR (përpunim)



ANEKSI 2  
Plani i Ri i Investimit

Plani i ri i investimit do të ndahet në tri faza me nga tre vjet secila, pra 9 vjet. Vlera totale (shtesë) e investimit do të jetë – **8.014.450 USD**. Fazat e investimit me vlerat përkatëse të investimit jepen në tabelën e mëposhtme:

Vlera e Investimit												
		NJËSIA	VLERA E INVESTIMIT	VITI I	VITI II	VITI III	VITI IV	VITI V	VITI VI	VITI VII	VITI VIII	VITI IX
<b>MINIERA E BAKRIT KARMA 2</b>												
1	STUDIME teknike specifike E PROJEKTIME të punimeve minerare, si dhe SHPIME VLERËSUËSE të rezervave minerare	USD	248 390	101 040	147 350	0	0	0	0	0	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA I +II	USD	4 041 600	0	0	336 800	505 200	1 178 800	2 020 800	0	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA III	USD	1 515 600	0	0	0	0	0	0	757 800	505 200	252 600
3	MAKINERI E PAISJE	USD	202 080	0	0	0	0	0	0	0	0	202 080
4	PUNIME PËRGATITTORE	USD	454 680	0	0	0	0	0	0	0	0	454 680
	SHUMA E INVESTIMEVE	USD	<b>6 462 350</b>	101 040	147 350	336 800	505 200	1 178 800	2 020 800	757 800	505 200	909 360
<b>MINIERA E BAKRIT MUNELLË</b>												
1	STUDIME teknike specifike E PROJEKTIME të punimeve minerare, si dhe SHPIME VLERËSUËSE të rezervave minerare	USD	78 750	26 250	0	0	26 250	0	0	26 250	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA I	USD	135 000	45 000	45 000	45 000	0	0	0	0	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA II	USD	135 000	0	0	0	45 000	45 000	45 000	0	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA III	USD	135 000	0	0	0	0	0	0	45 000	45 000	45 000
3	MAKINERI E PAISJE	USD	75 000	0	0	0	0	0	0	75 000	0	0
4	PUNIME PËRGATITTORE	USD	101 250	0	33 750	0	0	33 750	0	0	33 750	0
	SHUMA E INVESTIMEVE	USD	<b>660 000</b>	71 250	78 750	45 000	71 250	78 750	45 000	146 250	78 750	45 000
<b>MINIERA E BAKRIT LAK ROSHI</b>												
1	STUDIME teknike specifike E PROJEKTIME të punimeve minerare, si dhe SHPIME VLERËSUËSE të rezervave minerare	USD	42 000	16 000	26 000	0	0	0	0	0	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA I+II	USD	128 000	0	0	24 000	104 000	0	0	0	0	0
2	PUNIME MINERARE KAPITALE, FAZA II+III	USD	94 000	0	0	0	0	58 000	18 000	18 000	0	0



3	MAKINERI E PAISJE	USD	24 000	0	0	0	0	0	0	24 000	0	0
4	PUNIME PËRGATITTORE	USD	13 800	0	0	0	0	0	0	13 800	0	0
	SHUMA INVESTIME	USD	301 800	16 000	26 000	24 000	104 000	58 000	18 000	55 800	0	0
	<b>FABRIKA E MJEDËS</b>											
3	Makineri e pajisje	USD	80 000	20 000	20 000	40 000	0	0	0	0	0	0
5	Ndërtim, montime makinerish e pajisjeve për fabrikën e Mjedës	USD	420 000	0	0	0	240 000	180 000	0	0	0	0
6	Riparime, mekanizime, përmirësim kushtesh pune etj.	USD	90 000	0	0	60 000	30 000	0	0	0	0	0
	SHUMA E INVESTIMEVE	USD	590 000	20 000	20 000	100 000	270 000	180 000	0	0	0	0
	<b>TOTAL INVESTIME</b>	USD	8 014 150	208 290	272 100	505 800	950 450	1 495 550	2 083 800	959 850	583 950	954 360
				FAZA E PARË E INVESTIMIT			FAZA E DYTË E INVESTIMIT			FAZA E TRETË E INVESTIMIT		
	Vlera e Investimit sipas fazave			986 190			4 529 800			2 498 160		

**VLERA TOTALE E INVESTIMIT 8 014 450 USD**



## ANEKSI 3

Renta minerare & metodologjia e llogaritjes. Niveli i TVSH-së, Tatimit mbi Fitimit, Tatimit mbi Dividentin që do të aplikohet për Koncesionarin gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Koncesionit.

## TAKSA E RENTËS MINERARE

1. Taksa e rentës minerare për të gjithë produktet dhe nënproduktet të prodhuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Koncesionare do të aplikohet/llogaritet në masën 3% të vlerës së produktit ose nënproduktit të shitur.

2. Në përlllogaritjen e vlerës së rentës minerare, merren në konsideratë sasia dhe çmimi i mineralit apo nënproduktit të thatë të përcaktuar në faturën tatimore.

3. Metodologjia që do të aplikohet në përlllogaritjen e taksës së rentës minerare për produkte apo nënprodukte minerare të prodhuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Koncesionare, është:

Në rastin kur minerali shitet si produkt “mineral bakri”, vlera e taksës së rentës minerare për produktin “mineral bakri” është e barabartë me vlerën që rezulton nga shumëzimi i: 1) sasisë së mineralit të thatë, të dhënë në faturën tatimore (në ton); 2) vlerës prej 3%, të përcaktuar si përqindje e taksës së rentës minerare (0.03); 3) vlerës së çmimit të deklaruar në faturën e shitjes së mineralit të thatë (USD ose LEK/ton).

VLERA E TAKSËS SË RENTËS MINERARE për një faturë tatimore të produktit “mineral bakri” është e barabartë:

$$VTRM = (A)X(B)X(C)$$

Ku:

(VTRM) - vlera e taksës së rentës minerare për produktin “mineral bakri” për një faturë tatimore (në USD ose LEK);

(A) - sasia e mineralit të bakrit të thatë të dhënë në faturën tatimore (në ton);

(B) - vlera prej 3%, e përcaktuar si përqindje e taksës së rentës minerare (0.03);

(C) - vlerë e shkruar për çmimin e një toni mineral bakri të thatë në faturën e shitjes së mineralit (USD ose LEK/ton).

II- Në rastin kur minerali shitet si nënprodukt “koncentrat bakri” vlera e taksës së rentës minerare për nënproduktin “koncentrat bakri” është e barabartë me vlerën që rezulton nga shumëzimi i:

1) sasisë së koncentratit bakrit të thatë, të dhënë në faturën tatimore (në ton); 2) vlerës prej 3%, e përcaktuar si përqindje e taksës së rentës minerare (0.03); 3) vlerës së koeficientit të vlerës së mineralit (0.22858); 4) vlerës së çmimit të deklaruar në faturën e shitjes së koncentratit të bakrit të thatë (USD ose LEK/ton).

VLERA E TAKSËS SË RENTËS MINERARE për një faturë tatimore të nënproduktit “koncentrat bakri” është e barabartë:

$$VTRM = (A) X (B) X (C) X (D)$$

Ku:

(VTRM) - vlera e rentës minerare për produktin “koncentrat bakri i thatë” për një faturë tatimore (në USD ose LEK);

(A) - sasia e koncentratit të bakrit të thatë të dhënë në faturën tatimore (në ton);

(B) - vlera prej 3%, e përcaktuar si përqindje e taksës së rentës minerare (0.03);

(C) - vlerës së koeficientit të vlerës së mineralit (0.22858);

(D) - vlerë e shkruar për çmimin e një toni koncentrat bakri i thatë, në faturën e shitjes së mineralit (USD ose LEK/ton).

## NIVELI I TVSH-SË, TATIMIT MBI FITIMIT, TATIMIT MBI DIVIDENTIN

Niveli i taksave të TVSH-së, Tatimit mbi Fitimit, Tatimit mbi Dividentin që do të aplikohet për Koncesionarin gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Koncesionit do të jetë:

TVSH - 20%;

Tatimi mbi Fitimin - 15%;

Tatimi mbi Dividentin - 15%;

## VENDIM

Nr. 469, datë 30.5.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 6, të vendimit nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të



ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Artan Lame, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Ibrahim Morina emërohet drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

VENDIM

Nr. 470, datë 30.5.2017

**PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Kujtim Dumi, drejtor i Cirkut Kombëtar, shkarkohet nga kjo detyrë.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

VENDIM

Nr. 471, datë 30.5.2017

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 3, bashkëlidhur vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në “Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe dokumenti që duhet të paraqesin” shtohen shtetet:

“Rusia, Arabia Saudite, Bjellorusia, Gjeorgjia, Katari, Omani, me dokumentin pasaportë, për periudhën 31 maj - 15 nëntor 2017”.

b) Në “Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa viza si rrjedhojë e hyrjes pa vizë në zonën Shengen” shtohet shteti “Moldavia, me dokumentin pasaportë”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama



**VENDIM**  
**Nr. 472, datë 30.5.2017**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË  
 TRANSPORTIT PËR NË ATDHE TË  
 TRUPIT TË TË NDJERIT GJOVALIN  
 KADELI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të vendimit nr. 426, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbulimin e plotë të shpenzimeve të transportit për në atdhe të trupit të pajetë të të ndjerit Gjovalin Kadeli.

2. Shpenzimet përkatëse të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri me kod 606 “Transferata të kushtëzuara për individë”.

3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së dokumentacionit justifikues.

4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 473, datë 1.6.2017**

**PËR MARRJEN E MASAVE DHE  
 MONITORIMIN E VEPRIMTARISË,  
 SJELLJES APO PËRDORIMIT TË  
 BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE  
 DHE LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS  
 SHTETËRORE, GJATË PROCESIT  
 ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET  
 NË KUVENDIN E SHQIPËRISË  
 PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 7, 63, pika 4, 78, pika 5, e 88, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në

administratën publike”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017, me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve e partive politike në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike në procesin elektoral, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake.

2. Në kuptim të këtij vendimi:

- Administratë shtetërore është administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 4, të këtij ligji, ndaj të cilëve ky vendim do të zbatohet;

- Punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre janë nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë civilë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;

- Funksionarë kabineti janë nëpunës të administratës, sipas përkufizimit të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, ndaj të cilëve nuk zbatohet ky vendim;

- Punonjës policie, punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3, të ligjit nr. 152/2013, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elementë të tjerë rregullohen me ligje të posaçme, janë punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.





3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

4. Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

5. Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë lejen me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale si pjesë e shërbimit civil.

6. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

7. Nëpunësit civil, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, sipas pikës 4, të këtij vendimi, në kuptim të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, i ndalohet:

- a) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor;
- b) të manifestoje me pankarta, parrulla apo çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;
- c) të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike.

8. Punonjësit të Policisë së Shtetit i ndalohet:

- të jetë anëtar i një partie ose organizate politike;
- të mbështetë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtari partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht ose financiarisht.

9. Punonjësit të Gardës së Republikës i ndalohet:

- të silltet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës;

- anëtarësimi e pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike.

10. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i ndalohet:

- të manifestoje sjellje dhe të mbajë qëndrime, që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit;
- anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike;
- të bëjë propagandë në favor ose kundër partive, shoqatave politike ose kundër kandidatëve në zgjedhje.

11. Ushtrarakut aktiv të Forcave të Armatosura i ndalohet:

- të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik;
- të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre.

12. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare a njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

13. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre të organizojnë menjëherë punën dhe të marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e administratës shtetërore, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore, të çdo niveli, për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 25 qershor 2017.

14. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre të kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve nën varësinë e tyre, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

Për efekt të zbatimit të kësaj pike, përveç masave të tjera, titullarët janë të detyruar që të publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare të internetit, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.



15. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre verifikojnë dhe analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale.

16. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të garantuar mospërdorimin e:

a) burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

b) fondeve të institucioneve për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;

c) mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara për këto zgjedhje;

e) zhvillimit të fushatës zgjedhore në institucionet publike apo realizimit të propagandës politike në to;

d) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;

dh) detyruar, në fushatë zgjedhore, të administratës së institucionit brenda ose jashtë orarit të punës, si dhe të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar brenda ose jashtë orarit mësimor.

17. Në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 63, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, titullarët e ministrive ose drejtuesit e institucioneve të varësisë marrin masa për pezullimin nga detyra të nëpunësve civilë të institucioneve të tyre, të cilët janë regjistruar si kandidatë për zgjedhjet e Kuvendit, të datës 25 qershor 2017. Për nëpunësit e tjerë, marrëdhënia e punës të të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, merren masa, sipas rastit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës apo pezullimin nga detyra në rastet kur rezultojnë që janë regjistruar si kandidatë në listat e zgjedhjeve.

18. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit të administratës shtetërore, ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara në zgjedhje.

Bën përjashtim nga ky ndalim përdorimi i automjeteve të Gardës së Republikës dhe të Policisë së Shtetit, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale.

Strukturat e Policisë së Shtetit, kur konstatojnë përdorimin e automjeteve shtetërore të institucioneve të pushtetit qendror e vendor për veprimtari të fushatës zgjedhore, të bëjnë bllokimin e tyre dhe, menjëherë, të njoftojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe titullarin e institucionit në përdorim të të cilit është automjeti. Automjeti të zhbllokohet pas ekzekutimit të masës së marrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor. Në këtë rast, struktura e Policisë së Shtetit bën referim në organet kompetente për përdorimin e të mirave publike në favor të subjekteve zgjedhore.

19. Titullarët e ministrive dhe/ose drejtuesit e institucioneve të varësisë ose personat e ngarkuar prej tyre marrin masa për të iniciuar procedura të reja prokurimi publik, koncesioni apo partneritet publik-privat, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri në përfundimin e fushatës zgjedhore, me përjashtim të rastit të procedurave urgjente dhe të domosdoshme për funksionimin e institucionit, të cilat vlerësohen dhe miratohen rast pas rasti për të gjitha institucionet e varësisë nga ministri përgjegjës i fushës, pas miratimit paraprak nga Kryeministri.

20. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në zbatim të detyrimeve të tij për organizimin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, të marrë masa dhe t'i parashtrijë Kryeministrit mospërfshirjen në rendin e ditës të projektvendimeve në lidhje me koncesione, kontrata apo angazhime të tilla politike, ekonomike apo sociale që nuk vijnë në zbatim të programit analitik të çdo ministrie/institucioni, siç është miratuar nga Këshilli i Ministrave.

21. Ministrinë dhe institucionet e varësisë, me qëllim shmangien e keqpërdorimit dhe keqinterpretimit të aktiviteteve institucionale me fushatën elektorale, të publikojnë në faqen e tyre zyrtare:

a) deri në datën 5 qershor 2017, të dhënat për aktivitetet publike, të programuara për muajt



qershor dhe korrik, që kanë lidhje me veprimtarinë e institucionit;

b) listën e projekteve të nisura prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, në ushtrim të punës dhe veprimtarisë së institucionit, të cilat janë në proces përfundimi, si dhe të gjitha procedurat publike konkurruese të realizuara gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit.

22. Ministrinë dhe institucionet/organet e varësisë t'u krijojnë vëzhguesve dhe shoqatave të regjistruara në KQZ, si vëzhguese të procesit zgjedhor, akses të plotë për të marrë informacion në lidhje me detyrimet ligjore të administratës publike në procesin zgjedhor. Ministrinë dhe institucionet/organet e varësisë informojnë publikun në mënyrë të vijueshme për monitorimin e realizuar në kuadër të këtij vendimi.

23. Për koordinimin e procesit të monitorimit sipas këtij vendimi, krijohet Task – Forca që drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje:

- Ministrin e Punëve të Brendshme;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
- Ministrin e Drejtësisë;
- Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore;
- Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
- Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave.

Në mbledhjet e Task-Forcës ftohen të marrin pjesë:

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- Avokati i Popullit;
- Një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në mbledhjet e Task-Forcës ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga organizma ndërkombëtarë, në raste kur Task-Forca e gjykon të nevojshme marrjen e asistencës teknike lidhur me çështje të procesit zgjedhor.

24. Task - Forca mbështetet nga një sekretariat

teknik i përbërë, përkatësisht, nga një nëpunës i Kabinetit të Kryeministrit, Kabinetit të Zëvendëskryeministrit, aparatit të Këshillit të Ministrave.

Çdo institucion i përfaqësuar me anëtarë në përbërje të Task-Forcës cakton një punonjës kontakti që asiston sekretariatit teknik gjatë veprimtarisë së tij.

Sekretariati teknik përpunon të gjithë informacionin e mbledhur dhe ia referon Task-Forcës.

25. Task-Forca mbledhet me njoftim nga kryetari periodikisht të paktën një herë në javë ose sa herë që vlerësohet e nevojshme prej tij ose të paktën prej 2 anëtarëve. Në mbledhjet e saj Task-Forca, sipas rastit, cakton detyra më të detajuara për secilin anëtar, si dhe, nëse e konsideron të nevojshme, miraton një plan veprimi apo masash për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.

Çdo institucion shtetëror dhe institucion i pavarur, pjesë e Task-Forcës, raporton me shkrim periodikisht lidhur me zbatimin e masave të detyrave të ngarkuara, si dhe për problematikat e hasura gjatë procesit të monitorimit sipas këtij vendimi.

26. Ngarkohen Policia e Shtetit dhe/ose Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave t'i raportojnë me shkrim Task-Forcës çdo rast kur konstatojnë përdorim në procesin zgjedhor të mjeteve financiare të krijuara nga veprimtari të paligjishme.

27. Task-Forca, brenda sferës së veprimtarisë së vet, kur e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve informacion me shkrim për veprimtari në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, për të cilat ky i fundit merr dijëni nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

28. Task-Forca, nëpërmjet zyrës së shtypit të Kryeministrit, komunikon me publikun për çështjet e shqyrtuara dhe masat e marra.

29. Task-Forca të ushtrojë funksionet dhe të përmbushë detyrat e sipërpërmendura deri në përfundimin e procesit zgjedhor.

30. Titullarët e ministrive urdhërojnë ngritjen e grupeve të monitorimit/inspektimit për mënyrën e zbatimit të këtij vendimi dhe në funksion të informimit të Task-Forcës, duke përcaktuar edhe detyrat konkrete dhe veprimtarinë që do të mbikëqyrin këto grupe.



31. Task-Forca, në bashkëpunim me titullarët e ministrive dhe grupet e monitorimit, të përmbushë detyrat, si më poshtë vijon:

a) Monitorimin e sjelljes dhe veprimtarisë së administratës shtetërore sipas këtij vendimi;

b) Monitorimin e administratës shtetërore në drejtim të përdorimit të autoritetit shtetëror vetëm në përputhje me ligjin duke mos lejuar përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të shtetit gjatë procesit zgjedhor si dhe duke mos lejuar kryerjen e veprimeve dhe/ose dhënien e premtimeve, favoreve apo moscenimin e të drejtave të shtetasve, si mekanizëm për favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik;

c) Monitorimin e procesit zgjedhor me qëllim konstatimin dhe raportimin e përdorimit gjatë fushatës dhe procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme;

ç) Monitorimin e procesit zgjedhor, përfshirë ditën e votimit, në funksion të mospërfshirjes në të të zyrtarëve apo personave të tjerë që ndodhen në institucione shtetërore, përfshirë personat e burgosur, dhe marrjen e masave për ndëshkimin e atyre zyrtarëve që veprojnë në kundërshtim me ligjin. Pjesë e kësaj detyre është edhe monitorimi i lëvizjes së nëpunësve të lartë dhe të mesëm shtetërorë në qendër dhe qarqe apo bashki gjatë procesit zgjedhor;

d) Monitorimin e përditësimit dhe ndjekjen e problematikave me listat e zgjedhësve;

dh) Monitorimin e zbatimit të masave për pezullimin e iniciativave për kontrata të përkohshme në nivel qendror e vendor;

e) Monitorimin e përditësimit të akteve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;

ë) Njoftimin apo kryerjen e kallëzimit penal në Prokurorinë e Përgjithshme për raste të marrjes/vënies në dijeni për kryerjen e veprave penale në fushën zgjedhore;

f) Njoftimin e Avokatit të Popullit kur merr apo vihet në dijeni për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë procesit zgjedhor;

g) Njoftimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kur merr dijeni apo vihet në dijeni për problematika të procesit zgjedhor;

gj) Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Policinë e Shtetit në funksion të marrjes së masave të menjëhershme në përputhje me ligjin kur konstatohen raste të sjelljeve apo veprimtarive të

kundërligjshme gjatë procesit zgjedhor;

h) Çdo detyrë tjetër në funksion të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi.

32. Moszbatimi i rregullave dhe detyrimeve të parashikuara në këtë vendim passjell përgjegjësi disiplinore dhe ligjore, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

33. Urdhri nr. 65, datë 12.5.2017, i Kryeministrit, “Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike të çdo niveli për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017”, shfuqizohet.

34. Ngarkohen anëtarët e Task-Forcës, ministrat, titullarët e institucioneve të administratës shtetërore, Departamenti i Administratës Publike dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**URDHËR**  
Nr. 124, datë 1.6.2017

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 113, DATË 22.5.2017, “PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 56 të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshilit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

URDHËROJ:

Shfuqizimin e urdhrit nr. 113, datë 22.5.2017, të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Për delegimin e kompetencave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE  
DHE RINISË  
Xhulieta Kërtusha

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë